TIRANA



1937

BKSH

N. M. e Tij Mbret' i Shqiptarvet
Themelues i Tiranës Kryeqytet

BKSH

BASHKIJA E KRYEQYTETIT

Zotnis Tsë Tij Mitëhat Frasherit

KUJTIM

Me rastin e XXV vjetorit të shpalljes
së vetë-qeverimit Shqipëtar

TIRANA

1604-1937
BOTUE PREJ
BASHKIS
NË RASTIN E 25 VJETORIT
TË PAMVARSIS

SHTYP. „LUARASI" - TIRANË

BKSH

BKSH

TIRANA

PKSH

Data e themelimit të Tiranës e pozita gjeografike e sajë.

Tirana âsht nji qytet i rí. Themelet e ndërtesavet të para të këtij qyteti, u vûnë në 1604 prej Sulejman Bej Mulletit, në fushë ku 160 vjet përpara Skënderbeu kalonte në paradë ushtrín e parë kombtare (1) të Shqipnís së lirueme prej tij.

Fusha e bukur e pjellore mbi të cilën po ngrifej qyteti i rí, i premtonte këtij nji shvillim e zmadhim të shpejtë mbassi nji trevë e madhe që fillon me malet e Krrabës e zgjatet gjer në lumin e Zezës, këtë fushë e ka si qendër të natyrshme dhe qyteti që themelohej, ishte nji treg i nevojshëm i gjith kësaj treve.

Pozita gjeografike e qytetit të rí, ishte zgjedhun me kujdes jo vetëm për qarkun e hapët e pjelluer, që ka, po edhe për rrugën e natyrshme, që kalon nëpër të e lidh dy pjesë me randësí të Shqipnís së Mesme: bregdetin me malsít nga lindja d. m. th. me Mat e Dibër që kan luejtë nji rrol me randësí në historín e Kohës së Mesme të Shqipnís.

---

(1) Historia e Skënderbeut prej Peshkopit Theofan, faqe 121.

Xhamija e Vjetër, para ç' dukjes vorresve, themeluc prej Sulejman Pashës 1604

Gojdhana mbi themelimin e emnin e Tiranës

Themeluesi i Tiranës ishte nji katundar modest prej Mulleti (1). Fusha mbi të cilën u ngref Tirana, nuk ishte pronë e tij. Në modestin e vet Sulejman Beu nuk do të kishte mundë kurr të themelojë nji qytet sikur nji fat i pa pritun mos t' i kishte trokllinë në derë e t' a bânte njerí me fuqí e të njohun. Ky fat q' i trokllinte në derë qe të thirrunit të tij në Stamboll prej nji Kryeministrit (Sadriazem) të fuqishëm të kryeqytetit tyrk.

Gojëdhana që mbahet e gjallë edhe sot në popullin e Tiranës, thirrjen në Stamboll të Sulejman Beut, e tregon në këtë mënyrë:

„Sulejman Beu kishte pasë nji barí dhensh që nji mëngjes tue i shtí uj duerësh për me lá syt, i kishte tregue nji andërr të çuditshme q' e kishte pá natën, sikur në krah të djatht i kishte lé Dielli e në krah të majt Hana.

Sulejman Beu nëpër interpretim, q' i bâni kësaj andrre, kuptoi se bariu i tij do të bâhet njerí i madh dhe plot besim n' interpretimin e vet, thirri bariun dhe e porositi me lanë dhent dhe me shkue për me kërkue fatin e tij".

Thirrja në Stamboll e Sulejman Beut qe bâ nga ky barí, q' i bâmun i madh dhe i mallëngjyem nga nji herë në kujtimet e jetës së shkueme në Mullet, ndinte nji nevojë për me i a shpërblye ish zotnís së vet, paratregimin e fatit të tij të shkëlqyeshëm.

(1) Mulleti âsht nji katund në breg t' Erzenit nja 11 km. larg prej Tirane.

Në mes të favorevet që pat Sulejman Beu në Stamboll prej ish bariut, qe edhe nji ferman (1) për të ngrefë nji qytet të rí në fushë që shtrihet në mes të Lanës e të Riglatës, përtej kodrave të Selitës e të Saukut, aty ku nji gojëdhanë e mbajtun e gjallë në popull, tregonte se dikur ka qenë nji qytet.

Mbassi u kthye në Mullet, nji ditë me disa njerëz të vet, duel të kontrollojë vendin ku do të ngrifej qyteti dhe vendosi të ndërtojë tri ndërtesa të para: nji xhamí, nji furrë e nji hamam, që jan gati si tri institute të para krejt të nevojshme për nji jetë qytetare.

Të vûmit e themeleve të këtyne tri ndërtesave në vend ku u caktue, nuk u bâ pa kundërshtime pse i zoti i fushës Sallman Beu, nji feodal i fortë, q'e kishte ndejtjen e tij në Selitë, nji katund afër Tiranës, nuk e kishte shitë vendin dhe nuk i kishte lejue kurrkuj me ngrefë ndërtesa në tokën e tij. Po sa u prenë landët në pyllin që mbulonte nji pjesë të fushës dhe u vunë themelet e xhamís me nji ceremoní të posaçme, Sallman Beu, të marrmen vesht këtë punë, me nji herë çoi njerzit e vet dhe i prishi e ndaloi çdo ndërtim mbi at vend të tij.

Sulejman Beu nga ky kundërshtim i pronarit u praps me nji herë pse me të s' mund të matej me fuqí dhe vendosi me kërkue intervenimin e Qeverís me anë të mikut të tij që kishte në Stamboll, tue e akuzue Sallman Beun si sakrileg për shembjen e themeleve të xhamís.

Në këtë kohë rrethi i Tiranës nuk ishte myslimanizue mirë (2). Nji pjesë e katundarëve q'ishte kthye mysliman, këtë e kishte bâ sa për faqe për t'i hik taksave të randa e angarive e jo pse me të vërtetë kishte pëlqye parimet e kishte vendosë për me u konvertue me konviksion në besimin e rí. Si konseguencë e këtij konvertimi të përcipët, zakonet nuk kishin ndërrue e jeta vazhdonte si përpara pa u ndím efekti i ligieve të reja të besimit të pranuem.

Sallman Beu i Selitës duket se ishte nji nga kta të konvertuem të përcipët pse bashkë me dhent mbante edhe derra dhe shembjen e themeleve të nji xhamije nuk e njihte si punë sakrilege sidomos kur ato themele ishin vû në tokë të tij pa leje e pa të drejtë. Mirpo Tyrqija e vjetër ishte shtet besimi e fajet q' u bâjshin në çeshtjet fetare i dënonte me rreptësí sidomos për të konvertuemit e rí q' i mbante gjithmonë nën nji mbikqyrje të posaçme.

Sallman Beu për punën sakrilege që bâni, u dënue me nji herë për vdekje dhe u ekzekutue. Ekzekutimi i këtij feodali të fortë, tmerroi gjith bejlerët që gjindeshin për rreth fushës ku do të ngrifej qyteti, e Sulejman Beu i Mulletit mbeti si zot i pa kundërshtueshëm i gjith kësaj ane.

Ndërtesa e parë e qytetit të rí, Xhamija e vjetër, u themelue në 1023 arabisht d. m. th. në 1604, datë që mâ vonë u muer si krye datë e themelimit të Tiranës

Tashti âsht për t'u pyetë se emnin Tiranë nga e gjetë Sulejman Beu q'i a vû qytetit të rí? Vallë âsht ky emni i ndonji qytetit të vjetër të shuem në gjurmë

---

(1) Hann-i thotë se Sulejman beu u emënuë Governator' i Ohrisë.

(2) D. Stefano Gaspari: «Relaciene della diocese di Durazzo në 1671. Hylli i Dritës Nr. 2 vjeti 1932 faqe 98.

Shtëpia e Zojës Qanie Libohova qi rrjedh nga familja e Sulejman Pashës

të cilit ndofta po ngrifej ky i riu, a po âsht ndonji emën i inspiruem nga rasat e themeluesi desh t' a mbajë si kujtim për veprën e tij ?

Nji gojëdhanë e Tiranës, na thotë se Sulejman Beu emnin e qytetit e muer nga nji plakë që e gjetë, kur po kontrollonte për të shënue vendin, tue tírë án në prak të kacollës së vet në breg të Lanës, andej nga do të ngrifej qyteti, të cilën ai po sa e paska pá e paska pyetë se ç' po bânte ? Ajo i u paska përgjegjë:

— „Po tír án·····!

E ai këtë përgjegje të plakës e paska marrë si emën dhe e paska quejtë qytetin e rí Tir-ánë . . . !

Mirpo nji gojëdhanë tjetër e vjetër e ruejtun edhe sot në Bendë, Malsí e Tiranës, tregon se në fushë ku âsht ngrefë qyteti i rí, andej pak mâ poshtë nga âsht Kroi i Shëngjinës, ka qenë dikur nji qytet i madh i quejtun Tiranë në të cilën Skenderbeu e kishte si zakon të hajë drekën, gjith sa herë i takonte të shkojë prej Kruje në Petrelë e viçeversa.

Mbas kësaj gojëdhane, që besojmë të két qenë e gjallë, në kohë që u themelue Tirana, edhe në Mullet, qyteti i rí u ndërtue në gjurmë të qytetit të vjetër, që duket u prish në kohë të luftavet me Tyrq, tue ruejtë gjithnji edhe emnin e tij të motshëm.

Tirana e vjetër për të cilën flet gojëdhana e Bendës âsht e sigurt se ka eksistue në kohë të Skenderbeut pse të gjithë historjanët e vjetër që kan shkrue mbi jetën e luftat e Heroit t' onë, e përmendin disa herë në historít e tyne. Biemmi tue folë mbi ushtrín e parë kombtare të Skenderbeut thotë se kjo ushtrí u mblodh në fushën e Kasharit (1) q' ishte nji katund i Tiranës së Vogël e kështu shënon në mënyrë të qarët se n'atë kohë eksistonte nji qytet me emnin Tiranë, në kto ana ku u ngref qyteti i rí.

---

(1) «Presso Cassari villaggio di Tiranna minore avendo dato la Rassegna all'esercito...» Biemmi: Istoria di Giorgio Castrioto detto Skanderbegh: faqe 41. Kashari dhe sot âsht katund i Tiranës.

Barleti tue folë mbi Tiranën, ep spjegime edhe mâ shumë pse tregon që ka dy Tirana (1) nji e madhe 9 mil larg Krues e nji e vogël 4 mil. larg Krues e kështu në kundërshtim me Biemmin len me kuptue se njana ku âsht themelue Tirana e ré ka qenë Tirana e Madhe e jo e vogla pse kjo ìshte shumë afër Krues.

Sido qoftë, nga kta dy historjanë të vjetër nji gjâ që rezulton e sigurtë âsht se nji qytet me emnin Tiranë ka qenë në kto ana ku u ngref Tirana e ré.

Tashti tue dijtë kto, mund të thohet me siguri se Tirana e Ré, ru emnin e qytetit të vjetër e se edhe ndërtimi i sajë në fushën ku u bâ, u shkaktue mâ tepër, nën influencë të gojëdhanës, nga dëshiri për të përtrí qytetin e shuem, në vendin e vet, sigurisht tue u çmue se ai vênd âsht i favorshëm edhe për zhvillimin e qytetit të rí.

Nji portë në murin e Kalasë

(1) «Tiranna majore, fic dictat propter aliam minorem quae Crojam jacet . . .» — Barleti: Hıstaria de vita e Gestis Skanderbegi, Epirotarun principis; faqe 21.

Kisha e Shën Prokopit

Zhvillimi i Tiranës në dy shekujt e parë të jetës së sajë

Në vjetët e parë, zhvillimi i Tiranës qe i ngadalët e i vështirë pse themeluesi po sa mbaroi disi ndërtesat e para: xhamin, furrin, hamamin e shtëpin e vet, në breg të Lanës; u largue prej Tirane e s' ktheu mâ i gjallë. Largimi i tij u shkaktue nga lufta e Tyrqís me Persí, në të cilën muer pjesë edhe ai si vullnetar me nji fuqí të vetën. Në luftë, për trimní u shque mjaft sa u bâ edhe pashë, mirpo këtë titull të nal'të s' e gëzoi për shumë kohë pse në 1608 u vra, e trupi i tij si mbas porosís që u kishte pasë lanë të vetve, u suell në Tiranë dhe u vorrue pranë xhamis së vet. Mâ vonë për vorrin e tij u godit edhe nji far mauseleumi që eksiston edhe sot.

Me vdekjen e themeluesít, qyteti i ri për shumë kohë mbeti pa nji kujdestar të mirë. Djali i tij Ahmed Myftar Beu që ma vonë u bâ edhe pashë, nuk u interesue shumë për qytetin. Me gjith këtë, banorë, pak a shumë, filluenë të vin e shtëpija të reja të godituna pa rregull, formuenë lagje të vogla tue i dhanë qytetit nji pamje mâ të gjallë.

Ahmed Myftar Pasha rroi shumë sa pat fatin t' a shofi qytetin disi të formuem edhe vetë pse në kohë të tij, nja 40 vjet mbas themelimit, erdhi edhe nji kadí e kështu Tirana u njoh edhe prej qeveris si nji qendër urbane.

Si kujtim i kujdesit të tij për qytetin, ka mbetë vetëm minarja e Xhamis së vjetër q' u bâ në 1633 e nji krue pranë xhamis që sot nuk eksiston mâ.

Tiranës si qytet, zhvillimin mâ të madh, i a dha Ibrahim Beu, djali i tij, që kishte bâ studime të mira përjashta (Venedik) e ishte pregatitë për të qenë nji kujdestar mâ i mirë për qytetin.

Në këtë kohë, Tyrqija nuk kishte organizime bashkijake e qytetet kishin mbetë si katundet pa ndonji autoritet që të përkujdesesh për 'ta. Të qenunit të nji kujdestari t' interesuem për qytetet e vogjël jo vetëm q' ishte i dobishëm po edhe i nevojshëm sidomos kur kto ishin në fillim të zhvillimit të tyne.

Tirana, si qytet i rí, në Ibrahim Beun gjet kujdestarin q' i duhej pse ay po sa muer punën në dorë, pregatiti nji plan për të, drejtoi rrugat, zmadhoi hamamin dhe u dha banorëvet tokë mjaft për të pasë jo vetëm kopështije për rreth shtëpijave për lule e pemë po edhe ndonji copë arë për të mbjellë ndonji gjâ tjetër të nevojshme. Për të lá qytetin dhe për të futë nën uj fushën e Tiranës, dau nji rremë uji prej Riglate dhe e kaloi në mes të qytetit tue e ndá në shumë vija.

Mbas këtyne punëve goditi edhe kalán e i siguroi si familjes së vet ashtu edhe popullit, nji vend të mirë mprojtjeje në rasë lufte.

Mirpo për shumë arsye prej qeverís, mbahej si njerí i dyshimtë dhe ndiqesh. Kryengritjet që bâheshin në Tiranë e në qark të sajë kundra sundimit tyrk, për shkak të taksave të randa e ndihmave të detyrshme, dyshimin e qeverís mbi të e shtojshin gjithnji gjer sa Sulltani urdhnoi burgimin e tij dhe konfiskimin e të gjithë gjâs e të pasunís.

Vuejti mjaft; për falje të tij nonse i u lutën Sulltanit njerëz me randësí si hani i Krimit Kapllan Qiraj, ay mezi u fal në 1727 mbas disa vjet mundimesh, me konditë që të rrijë urtë në shtëpí të vet e mos të përzihet mâ në punët e popullit.

Ishte i interesuem, e për zhvillim të Tiranës do të përpiqej. Për shtim të popullatës filloi t' api edhe mâ lehtësí jo vetëm tue dhanë troje po edhe tokë me çmime mjaft t' ulta.

Në kohë të tij Tirana u zmadhue mjaft e muer nji randësí sa u bâ edhe si Nënprefekturë bashkë me Kruen. Përpara lidhej me këtë, si nji qytet — katund i thjeshtë pa nji rreth pse katundet e sajë pjesërisht i merrte ajo e pjesërisht Petrela që në këtë kohë ishte si krahinë. Po sa u bâ Nënprefekturë, katundet për qark i muer si rreth të sajë e filloi nji jetë qyteti të rregullë në çdo pikëpamje.

Për t' i dhanë nji zhvillim mâ të madh tregtís, në 1756, u krijue edhe panairi vjetuer „Shën Lleshi" që vazhdon edhe sot.

Me shtimin e popullsís, qyteti u përhap mjaft. Për lagjet e reja q' u formuenë, u bânë edhe disa xhamija të reja në mes të cilave meriton të përmendet për minaren që ka, xhamija e Zaimit q' u ndërtue në 1770. Minareja e kësaj xhamije të vogël ka nji elegancë të madhe sado që guri i sajë ka qenë nji far bigori i ashpër që s' ka hangër daltë mirë e pastaj âsht lye me harasan e ka humbë shumë nga bukurija e sajë.



Xhamija e Zaimit

Xhamija e Haxhi Ethem Beut themelue prej Molla Beut më 1789.

Ibrahim Beu për politikë simpatizonte Bushatasit e Shkodrës e ishte gjithnji në relacione të mira me ta sa do që Tirana administrativisht lidhej me Ohër. Kurt Pasha i Beratit q' e dinte mirë këtë simpathí, për t' a futë edhe Tiranën mbrenda qarkut t' influencës së tij, e mësyni nji ditë pa beft dhe desh të hyjë mbrenda në qytet. Mirpo sa hyni në kufí, qëllimi i tij u kuptue e populli i Tiranës i armatosun i duel përpara dhe filloi luftën me të. Ishte dimën e lufta zgjati me mundime të mëdhaja për të dy palët.

Nji ditë nji e msyeme q' i u bâ ushtrís së Kurt Pashës edhe mbas shpine nga nji Tiranas (Hys Asllan Plaku) me nja dymijë vetë, i dha fund luftës e Kurt Pasha i mundun mezi shpëtoi.

Me mbarimin e luftës fitimi u kremtue me shkëlqime e të gjithë ata që muerën pjesë në mprojtje të qytetit e treguenë trimní, u nderuenë me të madhe.

Meriton të shënohet se para kësaj lufte banorë orthodoks në qytet nuk kishte. Katolikë kishte fare pak po nji familje e tyne ishte nga të parat familje që kishin ardhë po sa u themelue qyteti.

Në fushë të Tiranës, para luftës, kishin pasë ardhë disa familje orthodokse nga Llanga e Myzeqeja po kto si familje barísh q' ishin, nuk banojshin në qytet. Në luftën q' u bâ, muerën pjesë në mprojtje të Tiranës edhe kto e u damtuenë në dhent e tyne. Ibrahim Beu si për shpërblim u fali fushën përtej Lanës ku u ndërtue kisha e Shën Prokopit e familjes Voilla i fali edhe dyqane. Mbas kësaj date kto familje dalë nga dalë filluenë të vendosen në qytet e të merren me tregtí e mjeshtrí të vogla tue hekë dorë nga blegtorija.

Lufta me Kurt Pashën për Ibrahim Beun qe fatale pse la të kuptohet që gjindet në nji qendër të fortë e në rasë nevoje mund të bâhet edhe i rrezikshem. Sulltani për t' a hekë qafet me kohë, urdhnoi Valin e Rumelís që t' a tërheki me dhelpní në qendër dhe t' i presi kryet e t' a nisi për Stamboll.

Pa dijtë se ç' pregatitej për të, Ibrahim Beu u nisë për Manastir dhe aty u eksekutue. Kryet e tij âsht vorrue në Merkez-Qoj të Stambollit.

Para luftës me Kurt Pashën, kishin ardhë për të banue në qytet edhe disa bejlerë të rí në mes të cilve shquhej për pasunín e zgjutsín e tij nji far Molla Beu i ardhun prej Petrele. Ky ishte ambicjos e me vdekjen e Ibrahim Beut u mundue të zajë edhe vendin e tij sadoqë ai kishte lanë nji djal mjaft të rritshëm. (1).

Për të fitue simpatín e popullit, pranë shtëpis së vet q'e kishte aty ku âsht ndërtue tashti Pallati i Ministrís së Luftës, themeloi në 1789 Xhamín mâ të bukur e mâ artistike të Tiranës që quhet sot Xhamija e Haxhi Etem Beut.

Mirpo familja e themeluesit kishte të drejta të pa kundërshtueshme mbi qytet, e vendin e saj s'mund e zente kush gjer sa ajo nuk ishte e shueme.

Ahmed Beu, djali i Ibrahim Beut, dalë nga dalë e muer vehten nga tronditja e madhe që pësoi me eksekutimin e t'et e filloi disi edhe t'interesohet për qytetin. Me gradimin e vjerrit të tij, Ibrahim Pashë Bushatit, si vali i Rumelís, u gradue pashë e u bâ për nja dy vjet edhe si sundimtar i Elbasanit. Në 1803 vdiq prej pike. Emni i tij përmendet për nji pyrg të gjatë q'i shtoi shtëpis së vet në kala që mjerisht sot nuk eksiston mâ. La nji djalë e katër vajza. Djali i tij Kahramau Beu, mbas vdekjes t'et, qe thirrë nji ditë si mik në Krue dhe prej andej [s'ktheu mâ i gjallë. Populli í Tiranës e qau si të mbytun prej Kapllan Pashës.

Me vdekjen e këtij pinjolli të fundit, famílja e themeluesit, për mashkull u shue, eksakt dy shekuj mbas themelimit të qytetit.

Të shuemit e kësaj familjeje mbas dy shekujsh përpjekjeje për të zmadhue e zbukurue Tiranën, qe për popullin mjaft i tristueshëm. Dy shekuj jetë, e kalueme së bashku plot dashuní e intimitet, e kishin bâ familjen e themeluesit si familje — atë të pa ndashme prej tij. Mirpo tashti nji fat i keq e i pa pritun nuk po e ndante vetëm, por edhe po e shuente cok në kohën mâ të bukur, atë herë kur qyteti, pjella e sajë, me të drejtë mund të krenohej se ishte bâ mâ i bukuri e ndofta edhe mâ i madhi i Shqipnís së Mesme.

Me mbarimin e shekullit të dytë, Tirana kishte 480 dyqane e gati 2000 shtëpi.

Pazari i vjetër para Xhamis Haxhi Ethem Beut
(tash pershimë prej Skenderbej)

(1) Hanni thotë se Molla Beu âsht nga desandantët të Sulejman Pashës.

Tirana në shekullin e fundit të sundimit tyrk

Shekulli i fundit i sundimit tyrk, që koincidoi me shekullin e tretë të Tiranës, filloi me trazime të mëdhaja për qytetin. Me shtimin e popullsís, ishte shtue edhe tregtija e kishte fillue të dalë nga dalë të formohet në qytet nji klasë e pasun tregtarësh e pronarësh që dojshin me e pasë vetë sundimin në dorë. Kjo klasë, mbas vdekjes s'Ibrahim Beut kishte bâ edhe provat e para e kishte mund t'a sundojë vendin me qetsí e drejtësí mjaft të madhe. Të shuemit e familjes së themeluesit, që kishte të drejta të fitueme në sundimin e qytetit, kësaj klase tashti po i epte rasën të forcohet edhe mâ tepër në pozitën e vet e të mprohet, në rasë nevoje edhe me forcë kundra çdo intervenimi të huej në punët e qytetit.

Mirpo martesa e katër vajzavet t'Ahmed Pashës krijoi nji çeshtje të rrezikshme pse dhandrrat ishte frika që të vinë në Tiranë e të pretendojnë edhe të drejta mbi sundimin e vendit. Për t'u eliminue ky rrezik, u mendue së pari që vajzat të martohen me Tiranas e në këtë mënyrë të shpëtohet edhe pasunija e madhe e Ahmed Pashës mbi të cilën për veç Toptanve të Krues, kishin ngulë sy edhe shumë bejlerë të tjerë të qyteteve kufí me Tiranën.

Ndër sa parësija e qytetit mundohej për të zbërthye këtë çështje të randë në paitim me interesat e qytetit, gjyshi i vajzavet Ibrahim Pashë Bushati e martoi vajzën e madhe, me Sulejman Bej Peqinin i cili nji natë, pa pritë e pa kujtue, erdhi në Tiranë dhe hyni si kollovar në shtëpi t'Ahmed Pashës.

Parësija të marrmen vesht këtë punë, u idhnue mjaft dhe për mos me kri-

Shtëpija e Toptanve

Shtëpi me stil të vjetër në rrugën Hoxhë Tahsin

jue nji precendent të keq edhe për martesën e vajzave të tjera, vendosi t' a dëbojë dhandrin e rí që natën e parë. Ndër sa dhandri kishte hangër darkë e ishte pregatitë për t' u qetsue në dhomën e fjetjes, katër tiranas t' armatosun po e ruejshin në penxhere dhe po sa ra, i hynë mbrenda në dhomë dhe e friksuenë të hiki po atë natë pa takue me fatin e vet. Sulejman Beu tue e pá vehten ngushtë, preferoi të shpëtojë jetën e të hiki; vetëm u lut që të lêhet me fjetë në nji dhomë tjetër gjer sa të gëdhî e mbasandej të niset.

Me të vërtetë të nesërmen, si mbas fjalës që dha, pa gëdhî mirë, hiku prej Tirane e hoq dorë prej martese për gjithmonë.

Ibrahim Pashë Bushati nga kjo ngjarje e pa pritun u fye shumë dhe n'idhnim e sipër, për të çue nderin e vet në vend, vendosi me e lá me gjak dhunën e bâme. Së pari thirri në Shkodër Mulla Beun nga parësija dhe e vrau; mbasandej pa humbë kohë mblodh nji fuqí të madhe dhe u nis vetë për Tiranë tue u përbetue se nuk do të lâjë gur mbi gur në qytet.

Kjo fuqí po sa i u afrue Tiranës, qe pritë prej popullit me luftë që ngjati disa kohë me dame të mëdhaja për të dy anët. Ndër sa Ibrahim Pasha po priste fitimin me pa durim, nji ditë në Laprake, nji vend nja nji gjysë ore larg Tiranës, i hyni nji mizë kali në vesh dhe vdiq. Me gjith këtë, fuqija e tij hyni në qytet e mbassi vrau dogj e plaçkiti sa mundi, u kthye prap për Shkodër.

Të bjerrunit e kësaj lufte nonse shkaktoi dame në qytet, për popullin nuk qe fort i randë për arsye se vdekja e Ibrahim Pashës u interpretue si nji far shpërblimi i naltë në favor të tij. Me gjith këtë, për të ndalë edhe të mësyeme të tjera të Bushatlive, filluenë të merren masat me kohë tue u bâ marrëveshtje edhe me disa dyerë të forta jashta Tiranës.

Në këtë kohë, Toptanët e Krues jo vetëm q'ishin të fortë po ishin n'anmiqsí të rrepët edhe me Bushatlit, e kështu për me bâ n'i far aleance kundra anmikut të përbashkët, u hy në bisedime me Kapllan Pashën. Marrveshtja qe e lehtë pse



Varri i Xapllan Pashës

Kapllan Pasha kërkoi vetëm martesën e katër djelmve të tij me katër vajza t'Ahmed Pashës; sa për sundimin e qytetit ai u impenjue se nuk do të përzihet kurr tue pranue si konditë edhe mos ardhjen e vet për të banue për gjithnji në qytet.

Në bazë të marrëveshtjes së bâme, katër vajzat e Ahmed Pashës u martuenë në 1807 me katër djelm të Kapllan Pashës dhe dhandrat erdhën si kollovarë në Tiranë tue u shpërngulë për gjithmonë prej Krueje.

Mirpo pak kohë mbas dasmës erdhi në Tiranë edhe vetë Kapllan Pasha. Së pari ndejti si mik po mbasandaj në marrvesh'je me Ali Pashë Tepelenën që donte t'a fusi sa mâ parë edhe Tiranën mbrenda zonës s'influencës së vet, vendosi të ngulet ktu e t'a marri sundimin e qytetit vetë në dorë. Për t'u krye kjo punë sa mâ shpejtë, nji prej parsís: Qorr Kalesha, q'ishte thue-se mâ i forti e mâ i rrezikshmi, qe thirrë prej Ali Pashës në Janinë dhe qe mbajtë atje si peng; vllaznit Jella, Hysen Aga e Ahmed Aga, qenë vra në kalá e Haxhi Etem Beu qe kërkue për t'u vra, po s'u gjet pse e kuptoi rrezikun e me nji herë u largue prej Tirane. Mbas pak kohe, qe vra në Janinë edhe Qorr Kalesha e kështu Kapllan Pasha mbeti si sundues i pa kundërshtueshëm jo vetëm i Krues po edhe i Tiranës.

Me ardhjen e Kapllan Pashës në Tiranë, qendra e nënprefekturës Krue-Tiranë u translokue në Tiranë, e Krueja dalë nga dalë filloi t'a humbi randësín politike të sajë. Për veç randësís politike, qyteti nën sundimin e gjatë të Kapllan Pashës, nuk fitoi gjâ pse në kohë të tij, nuk u godit ndonji send që meriton të përmendet.

Vdiq në 1816 i helmatosun prej nji njeriu t'Ibrahim Bej Kavajës.

Shtëpije me stil të vjetër në rrugën Xhemal Pashë Zogu

Nji vjet mbas vdekjes së tij, Haxhi Etem Beu me nji fuqí të mbledhun në Kavajë e Shkodër e mësyeni Tiranën dhe mbas nji lufte të vogël të bâme me antarët e Toptanve, hyni në qytet. Të bijt e Kapllan Pashës të mundun në këtë luftë, hikën, e Tirana ktheu prapë në gjendjen e sajë të përparshme.

Haxhi Etem Beu po sa u vendos në shtëpín e vet, filloi të plotësoi xhamín e t'et që kishte mbetë pa minare e pa u zbukurue për mbrenda. Ky zotni ishte i zgjutë e mjaft i dijshëm. Për t'a plotsue xhamín në mënyrë që të mbesi si nji monument me vlerë për qytetin, kërkoi mjeshtrit mâ të mirë e mâ të zott që kishte Shqipnija n'atë kohë. E me të vërtetë, dekoracionet e murevet e minareja që u bâ, jan nga ato mâ me vlerë e mâ të bukurë që ka vendi i yn sot.

Mbassi mbaroi xhamín, bani edhe nji medrese aty ku âsht sot Hoteli Splendit e mâ vonë nisi edhe pyrgun e sahatit të cilin e la pa mbarue. Pyrgu mbas do kohësh u plotsue me ndihmat e popullit.

Mirpo gjendja kështu nuk vazhdoi shumë pse në 1822, djali i Kapllan Pashës Abdurrahman beu me nji fuqí të mbledhun ndër miq në vise të ndryeshme, ktheu ngadhniyes prap në Tiranë.

Abdyrrahman Beu ishte njerí i mendshëm, nonse në Tiranë u kthye me fuqí t'armëvet, u suell shumë butë. Sjellja e tij qe influencue gjer diku edhe nga rrethanat pse bash në këtë vjet Ali Pashë Tepelena u dënue prej Stambollit e filloi të ndiqet me rrebtësí gjer sa u vra.

Hotel Splendidi tue u shëmbë për zgjanimin e Sheshit Skënderbej

Për të pajtue punët disi edhe ma mirë, mbas do kohësh u paqësuë edhe me kundërshtarët e vet të cilët u kthyenë në Tiranë e rruenë në miqsí të plotë me té.

Në kohë të tij u suell uj i mirë për t'u pí nga Linza (¹) e u shpërndà me anë shtatë krojesh në qytet. Ky uj qe shumë i shëndetshëm po nuk vazhdoi të vijë për shumë kohë, për arsye se Linzakët kishin nevojë vetë për té dhe e prenë.



Kisha e së Madhes Virgjinë

Nji punë tjetër me randësi që u bâ në këtë kohë, qe të ndamit e Tiranës në 6 lagje. Përpara lagje të vogla të pa numërta e coptojshin qytetin në mënyrë që nji shtëpí me zi gjindej pse shumica e rrugavet s' kishte edhe emna.

Në 1834 Abdyrrahman Beu bâni nji medrese e nji bibliotekë me libra tyrqisht e arabisht. Vdiq në 1837. Mbas testamentit që pat lanë, xhamija e vjetër u meremetue me të hollat e tij në 1840 dhe u suell në gjendje që ka sot.

Abdyrrahman Beu, Tiranën e la të qetsueme mirë. Si riperkusion i ngjarjevet të mëdhaja që u zhvilluen në Tyrqí në dhetëvjetshin e fundit të jetës së tij, ishte shkaktue nji far habitjeje që e kishte bâ secilin të bâhet shumë prudent. Zhdukja e Ali Pashë Tepelenës, prishja e internimi i Mustafa Pashë Bushatit e i Ibrahim Bej Kavajës, organizimi i ushtrís së ré e shpallja e Tanzimatit e kishin trondítë krejt gjendjen dhe kishin bâ të harrohen grindjet lokale në nji të pritun të shqetsuem për të gjithë vendin.

Kjo periudhë që vazhdoi mjaft, shërbei për Tiranën si nji cilindër nën të cilin u zhdukën të gjitha kundërshtimet e mënít e veçanta e u fillue dalë nga dalë nji jetë lokale e qetë që vijoi për shumë kohë.

Mbas vdekjes s' Abdyrrahman Beut, sundimin e Tiranës e mori në dorë, biri i tij Ahmed Beu që vazhdoi në gjurma t' et tue u sjellë gjithmonë butë e ambël me popullin.

(¹) Linza âsht nji katund në rranzë të Dajtit nja 1 orë larg Tiranës.

Në kohë t'Ahmed Beut u bânë në qytet mjaft godina të reja në mes të cilavet meritojn të përmenden: Kisha e së Madhes virgjin, Post-telegrafi, Shkolla Qytetse e Kisha e Vangjelismos.



Shkolla Qytetse (Rushdije) turke dhe Post-telegrafa (tash të ç'dukun për zgjanimin e rrugës Carnarvon)

Katolikët nonse ishin të vjetër në Tiranë, për numër kishin mbetë fare pak sa për shumë kohë s'qenë në gjendje kurrsesi për me goditë nji kishë për nevojat e tyne fetare. Arqipeshvi i Durrësit imzot Rafael Ambrozi tue pa pamundësin që të goditet nji kishë me ndihmat e katolikëvet të qytetit, i u lut imperatorit t' Austrís Franc Jozefit, mbassi katolikët e Tyrqis ishin nën mbrojtjen e Austrís, dhe kisha e së Madhes virgjin u godit në 1856 me të hollat e tij.

Me Tanzimatin, në Tyrqí filluenë të zbatohen nji seri reformash e si efekt i tyne u hapën në Tiranë Post-telegrafi e Shkolla Qytetse, ndërtesat e të cilavet u bânë në 1862 në rrugën e Konteshës Karnavon. Kto ndërtesa s' eksistojnë mâ sot pse në 1926 u prishën për të zgjanue rrugën.



Kisha e Vangjelismos

Kisha e vangjelizmos u goditë në 1873 për nevojat fetare t'orthodoksve të qytetit mbassi kisha e Shën Prokopit ishte e vogël dhe pak larg qendrës.

Mbas pak dekadesh qetsija ndër banorë të Tiranës ishte zgjue nji dashuní e posaçme për qytetin. Shumë të pasun për t'u zbukurue qyteti e për t'u plotsue nevojat e tij jo vetëm që bâjshin rruga ura e faltore po lejshin me testamente edhe fonde të posaçme që t'u mbante ç' do gjâ në gjendje të mirë. Në këtë kohë sedra e qytetarëve ishte naltësue aq shumë sa nji lagje s' pranonte ndihma të lagjeve të tjera për ura, rruga e xhamija të lagjes së vet. Për shembull në këtë

kohë u goditën dy ura të bukura mbi Lanë: Ura e Tabakëve dhe Ura e Terzive që secila u bâ vetëm me ndihmat e lagjes për të cilën u godit, pa u pranue ndihma prej lagjeve të tjera të qytetit.

Tashti për të kuptue se në ç'gjendje kishte mbritë Tirana në këtë kohë,

Ura e Tabakve në funt të rrugës Carnarvon

ânsht mirë të ndëgjojmë dy udhtarë të huejë që e panë qytetin vetë me sy e ndejtë disa dit në të. Njani ndër kta udhtarë, zoti Johann Georg von Hahn Austriakë e vizitoi Tiranën në 1852; e tjetri Z. H. Hecquard Francez, në 1857.

Von Hahn-i i nis shënimet e veta mbi Tirauën kështu: „Tirana e fusha e saj ë më bânë nji përshtypje shumë të kandëshme. Skota e njerzve që banon ktu mbahet nga mâ të zhdërvjelltit, por edhe nga mâ biramelat e Shqipnís së Mesme. Arat kopshtîjet, bimët janë punue me kujdes dhe kto të fundit, mâ të shumtën, të rrethueme mirë. Bagtija âsht mbajtë mirë dhe në të mâ shumtat katunde gjinden shtëpija guri dy katesh, në të cilat shihet nji pastërti e mjaftë; kurrkund nuk duken gjurma vobeksije e mjerimi. Gjâja që më habiti mâ shumë qe qyteti të cilin un pandehsha t'a gjêjë nji çerdhe t'errët e të ndyetë kurse e gjeta të pastër, të bukur e të shtrim në nji fushë uj-shumët plot me kopshtîje e pemë, shikimi i afërtë i të cilve të bân me kuptue se ktu kurrkush nuk vuenë e nuk vdes për bukë.

Ndër të gjitha rrugët e qytetit hecin dy vija të vogla uji që lajnë e pastrojn çdo ndyesí.

Xhamijat e pikturueme me ngjyra të ndryshme, të ndërtueme në nji stil të bukur dhe të rrethueme me plepa e selvija, pyrgu rokoko i hijshëm i sahatit, të gjitha kto me lëvizjen e gjallë të popullit që në ditët e caktueme, mbush tregun tue u përshkue nepër qerre të shumta të tërhekuna prej buejësh, bashkohen në nji pamje origjinale që s'e kam pa kurrkund gjetiu në Shqipní.

Tirana ka 2000 shtëpí prej të cilave 6 jan katolike, 100 ortodokse e resti mysliman".

Von Hahn-i në shënimet e veta mbi Tiranën, shkon edhe ma gjatë po na po e kpusim, pse ato që thotë ma poshtë, jan sende q' i shofim edhe sot në qytet.

Tashti të ndëgjojm edhe Hecquard-in: „tri orë larg Krues, në mes të nji fushe q' âsht punue në nji mënyrë t' admirueshme në të cilën shifen ferma të shumta e të pasuna, âsht Tirana, qytet që ka nji popullsí 20 mijë frymësh prej të cilve 1000 janë ortodoks, 200 katolik e resti mysliman.

Kur vihet prej Shkodre në qytet, të hyemit âsht shumë i bukur, në të djatht e në të majt jan dy xhamija të bukura të mbulueme me piktura të shkëlqyeshme, pak mâ tutje nji pyrg katërkandsh në të cilin âsht vendos sahati i qytetit. Rrugat e saja të gjana, kan në të dy anët vija uji të rrjedhshëm që mbajnë freskët qytetin e pastrojn çdo ndyesí të tij".

* * *

Në 1865 u reformue administrata e Turqisë e u organizuenë vilajetet. Në këtë vit Tirana u bâ nënprefekturë në vehte dhe u lidh me Durrësin që u bâ prefekturë (sanxhak) e vilajetit (province) të Shkodrës.

Disa kohë mbas ktij organizimi të rí, si sundimtarë në Tiranë filluenë të vin të huej dhe vazhdoi kështu gjer sa Shqipnija u çkëput prej Tyrqije në 1912 e u shpall Shtet në vehte.

Ura e Terzive në rrugën e Elbasanit (tash e ç' dukun)

→ Tirana si qytet i themeluem prej Shqiptarësh dhe i zmadhuem e i zbukuruem nën gjenín e tyne, në kohën mâ t' errët të kombit e t' atdheut Shqiptar, po sa kaloi nën sundimin e të huejëve filloi nji periudhë dekadence, nji periudhë të mjerë që vazhdoi si nji varg netsh të zeza pa ndonji ditë të bukur.

Në këtë periudhë që vazhdoi gati një gjys shekulli nuk u goditë kurrgjâ, për veç një kazerme që u bâ me qerpiça, e do të shënohej në historín e qytetit me një vijë të zezë sikur prap një Shqiptar, një Tiranas, Esat Toptani, mos t' ishte interesue për Tiranën në 1907 e mos të kishte modernizue tregun e sajë.

Tregu i vjetër ishte me tahtabenda e aty ktu edhe me rruga të ngushta. Esat Toptani për t' a rregullue në pajtim me kohën, e prishi krejt dhe detyroi pronarët t' i godisin dyqanet në një sistem të rí ashtu sikur shifen edhe sot.

Tashti âsht për t' u pyet se Tirana si qytet, në kohë të Tyrqís sa banorë pat?

Për t' i u përgjegjë kësaj pyetjeje burime zyrtare tyrke nuk kemi.

Hahn-i, sikur u përmend ma sipër, na thotë se Tirana në 1852 kishte 2000 shtëpi d. m. th. 10 mijë banorë. Hecquard-i që vizitoi qytetin 5 vjet mbas Hahn-it, thotë se ka 20 mijë banorë.

Rregjistrimi i fundit tyrk që u bâ në 1911 pat shënue për Tiranën 15 mijë banorë.

Kuptohet vetiu se Tirana si qytet i rí e i mbrendshëm, pa tregti të madhe e pa industrí, s' mund të kishte banorë shumë e prandej kujtojm se numri i banorëvet të sajë në 100 vjetët e fundit të sundimit tyrk, u lëkund në mes të 10 mijëve e 15 mijeëve nuk e kaloi kurrë këtë numër.

Gjimnazi i Shtetit (ish kazerma turke)

Fotografi e planit Tiranës hartue prej austriakve në vitin 1916 ne shkallën 1 : 5000

Tirana prej 1912 gjer në shpalljen e sajë si Kryeqytet në 31 Dhetuer 1925

Asht për t' u shenue se Tirana çlirimin e sajë nga Turqija e shpalli në 26-XI-1912, dy dit para shpalljes s' independencës në 28-XI-1912 në Vlonë. Po me gjith këtë, lirija e sajë nuk ngjati shumë pse ushtrija Serbe e okupoi të nesërmen, okupacjon ky që vazhdoi gati pesë muejë.

Mbas pakë kohe nga lirimi prej fuqivet serbe, Tirana u bâ prap sheshi i nji lëvizjeje politike. Esat Toptani mbassi u kthye prej Shkodre si qendër të fuqis së tij mbajti gjithnji këtë qytet sa do që ndejtjen e tij si kryetar i Qeveris provizore që pat formue e kish në Durrës.

Rruga Nana Mbretneshë.
Data e çeljes: 1922-1923.
Dimensioni: gjatë 1000 m.
gjanë 20 m.
Kushtimi: Çpronsimi Fr.ari 204.500.–
Ndertimi i rrugës e i trotuarit
Fr. ari 108.000.–
Shuma: Fr. ari 312.500.–

Tirana si qytet vuejti mjaft vjetët e para t' independencës s' onë; ngjarjet qi pasuen penguen krejt zhvillimin e sajë. Me pushtimin e Shqipnís nga ushtrit Austro-Ungareze u duk së pari se për të muerrën fund vuejtjet; mirë po zija e spanjolja qi sollën me vehte ushtrit e hueja, shkaktuen vuetje e mjerime të reja; ma të mëdhaja sa vetëm në banorët dami qi pat qyteti mrrini gati në 4000 vetë.

Si kujtim të kësaj periudhe të vështirë t' okupacioneve të hueja, kemi vetëm Strehën Vorfnore që u themelue në 1917 për fëmijt qi kishin mbetë rrugave për shkak të zisë e të shuëmit të disa familjeve nga spanjola.

Tirana vazhdoi kështu pa ndryshime gjer në 1920 datë në të cilën pat fatin të bahet si Kryeqytet provizor i Shqipnis. Qeverija Komb'are e zgjedhun prej gjin't të kongresit të Lushnjes, e primun prej Ministrit të Punvet të Mbrendshme t' asaj kohe, tash N. M. Tij Zog I. Mbret' i Shqiptarvet, me 1920 erdhi dhe u vendos në Tiranë. Prej kësaj date për Tiranën e vogël fillojë nji periudhë e ré. 316 vjet përpara qe themelue për të qenë nji qendër modeste shkëmbimesh për nji popull bujkë qi vuente nga mungesa e nji tregu t' afërtë; tashti sa do qi përkohësisht po bahet qendra e jetës politike e shoqnore të tanë nji kombi qi po rilindej në liri e n' institute të veta.

Shtëpia e Z. A. Libohova
Në rrugën Nana Mbretneshë
Ndertue 1930

Legata Turke
Në rrugën Nana Mbretneshë
Pronë e Z. Dr. Qemal Jusuffatit
Ndërtue 1931

Për t' i u përshtat nevojave të réja, periudha e ré filloji me nji fazë të vështirë transformimi që u kalue me shumë dhimbje pse shumë ndërtesa të qytetit shumë rruga, shumë sende të lidhuna ngushtë me kohën e sbkueme, psuen nën operacione të dhimbëshme për t' u ndryshue e diku edhe për t' u çdukë fare.

Në 1922 me urdhënin e Ministrit energjik të P. të Mbrendshme u çdukën vorrezet që gjindeshin pranë çdo xhamije e pengojshin jo vetëm rregullimin e tregut po edhe até të gjith qytetit. Po në këtë vit u hap rruga e ré e Durrësit (rruga Nana Mbretneshë) që prishi shumë shtëpia e hangri shumë kopshtie mbassi ajo e vjetra qi shkonte nga Hotel Durrsi kishte shumë ndrydha e s' lente të shifet së largu qendra e qytetit; në fund të kësaj rruge që lidhë Kryeqytetin me Durrësin në vitin 1930 âsht ndertue Hangari madhështor i Shoqnis aerore Italiane „Ala Littoria" që, ndertim krejt me skelet hekuri dhe i mbuluem me lamjera të hekurta, mbulon nji sipërfaqe prej m² 5.000 dhe ka një naltësi prej m. 35. Për veç kësaj, po në këtë vit u zgjanue edhe rruga e 28 Nanduerit me prishjen të një rradhë dyqanesh të bukura, e muer drejtimin qi ka sot.



Hangari Aeroplaneve
në rrugën e Durrësit
Pronë e Shoqënis Ala-Litoria
Ndërtue në 1930



Gjyqi Filluer
Në rrugën Nana Mbretneshë
Pronë e Z. Islam Angonit – Ndërtue 1931-1936

Qëndra e Kryqit Kuq Shqiptar
Në rrugën Nana Mbretneshë
Pronë e Z. Shan Tepelena – Ndërtue 1330

Në 1923 u ba plani rregullues i qytetit prej Z. Ing. Eshref Frashëri dhe me ketë zhvillimi i qytetit filloi të marë nji drejtim ma të mirë e të studjuem. Ky plan për së shpejti ka me u ri-kqyrë dhe përmirësue në vështrim të zhvillimit të Kryeqytetit dhe në mbështetje të rilievit ekzakt të gjendjes së sotme, të bamë, mirësisht prej Institutit Gjeografik të Firences nën kujdesin e Z. N-Kolonel Stolfit me aparatat të përsosuna Aerofotografike në shkallë 1/1000.

Në 1924 u ba klubi Oficerave që ma vonë u zgjodhë si seli për Parlamentin. Kjo ndertesë tashti ka hye në radhën e ndërtesave historike të Kryeqytetit pse këtu u shpall Monarkia me Mbretin e I-rë të Shqiptarvet ZOG I. me 1 Shtatuer 1928 e këtu u aprovuen shumë ligje e kode që i dhanë ngjyrë e formë jetës s'onë Kombtare e civile të ré

Vjeti 1925 për Tiranën e përtrime ka nji randësi të madhe pse cok në këtë vit në 31 Dhetuer u shpall kjo në mënyrë definitive si Kryeqytet i Shqipnisë.

PARLAMENTI



Godina e Shoqënis
Stacioli e Fortuzi
në rrugën
Nana Mb·etneshë
ndërtue 1930

Adetto Militare
Pronë e Shtetit Italian
Ndertue në 1930

RRUGA 28 NANDUER
Data e zgjanimit: 1923.
Dimensioni: gjatë 200. m. gjanë 16-20 m.
Kushtimi: Çpronësimi Fr. ari 9,657.–
Ndërtimi i rrugës, asfaltimi, kanalizimi e trotuar . . . Fr. ari 16,400.–
Shuma Fr. ari 26,057

Tirana si Kryeqytet prej 31 Dhetuer 1925 gjer 28 Nanduer 1937

Shpallja e Tiranës si Kryeqytet suell me vehte nevoja të reja që u zbërthyen në nji veprim të rí të madhe dhe nji ritëm të nxitshem si për privatët ashtu edhe për Bashkínë. Jo vetëm nji pjesë nëpunsash po edhe shumë privatë për të goditë shtëpijat e tyne pritëshin caktimin e Kryeqytetit. Po sa muer fund vendosja e Tiranës si Kryeqytet në mënyrë definitive, këta t' interesuem filluen ndërtimin e shtëpijave të tyne. Me anë tjetër edhe Bashkija filloi zbatimin e planit në nji masë ma të gjanë diku tue hap rruga të reja e diku tue zgjanue e drejtue të vjetrat.

Në vjetet 1926-1927 u hapë rruga Mbretënore q' âsht ba sot nji nga rrugat ma kryesore të Kryeqytetit, vendi ku u çelë kjo rrugë, ka qenë përpara diku vorreze e diku kopshtije me shtëpija të vogla pa farë vlere. Po në këtë kohë u hap rruga Koço Kotta e u bashkue me rrugën e vjetër të Bamit që u zmadhue e muerë nji drejtim të rí.

Pakë ma vonë, në vitin 1928-1929 u zgjanue dhe sistemue Boulevard Mussolini që u ba nji nga arteret ma kryesore të Kryeqytetit i cili në vjetet 1934-1937 u asfaltue; në fillim të këtij Bulevardi tash âsht tue u ndertue Pallati qendruer i Bankës Kombtare të Shqipnisë i cili okupon nji sipërfaqe prej m² 1.500 dhe âsht parashikue se i plotësuem krejt ka me kushtue fr. ari 600.000. Rruga Xhemal Pashë Zogu u zgjanue me 1925-1928 dhe nji pjesë e sajë u shtrue me gurë të gedhendun në vitin 1924.

RRUGA MBRETNORE
Data e çeljes : 1926.
asfaltimi 1934
Dimensioni:
gjatë 350+375 = 725.– m.
gjanë 15 m.
Kushtimi :
çpronsimi fr. ari 110,180
ndërtimi
i rrugës } » 40,000 pjes I
i trotuarit } » 30,000 » II
i kanalit }
Shuma fr. ari 180,180

RRUGA K. KOTTA
Data e çeljes dhe e
zgjanimit : 1925-1927
Dimensioni : gjanë m.
12, gjatë 1010 m.
Kushtimi:
çpronësimi: fr.ari 3.000
ndërtimi i rrugës,
trotuarit e kanalit
fr. ari 40.000
Shuma: fr.ari 43.000

Shtëpia e
Z. Faik Shatkut
Në rrugën Koço Kotta
Ndërtue 1934

Shtëpija Oficerave
në Boulevard Mussolini
Pronë : Shtetnore.
Ndertue 1933-1934,

Boulevard Mussolini
Data e zgjanimit
e e ndërtimit 1928-1929
Dimensioni :
gjatë m. 1100 - gjanë m. 30
Kushtimi :

çpronësimi	Fr. ari	29,442
ndërtimi i rrugës, trotuarit e kanal	»	» 130,000
Shuma	»	» 159,442



Banka Jugoslave e Exp.
në Bulevardin Mussolini
pronë e
Z. Dr. Osman Junusit
ndërtne 1934

Godina e
Z. Abidin Nepravishta
në
Bulevard Mussolini
ndërtue më 1930

Punimet në
Bulevard Mussolini
dhe asfaltimi në
vitin 1937

Godina e
VII. Luarasi
në
Boulevard Mussolini
Përdorimi i katit përdhes
Shtëpija Botonjëse Luarasi
ndërtue më 1931

Streha Vorinore
në
Boulevard Mussolini
Pronë e Familjes Zela
ndërtue më 1928

Pamia e
Boulevard Mussolinit
së bashku me rrugën
Mbretnesha Nanë

Shoqënia «Sesa»
në
Boulevard Mussolini
Pronë e
Shoqënis Sesa
ndërtue më 1930



Legata Çekosllovake pronë e Z. Fejzi Alizoti ndërtue në 1930

Rruga Xhemal Pasha Zogu data e zgjanimit: Zgjanue gjatë viteve 1925-1934

Dimensioni:
gjanë 15 m. gjatë 2.200 m.
Kushtimi:

Çpronsue	*Fr. ari 39.740*
Ndërtimi i rrugës e i trotuarit	*90.000*
Ndërtimi i kanalit	*8.000*
Shuma Fr. ari	*137.740*

Medreseja e Naltë në rrugën Xhemal Pashë Zogu pronë e Komunitetit Musliman ndërtue më 1930

Shtëpija e
Z. Musa Juka
në rrugën Anin
pranë rrugës
Xhemal Pashë Zogu
ndërtue 1930

Gjendja e hershme
e s.eshit mbrapa
Bashkis para hapjes
Bulevard Zog I

Pamja e pjesës I
të
Boulevardit Zog I

BIGT

BOULEVARD ZOG I Data e çeljes: 1930 - Dimensioni: m. 35 gjanë 800 gjatë
Kushtimi: *Çpronësimi Fr. ari 559.776 Ndërtimi 810.000 Shuma 1369726*

Ura e Lanës
në
Boulevard Zog I
në
Tiranën e Ré
ndërtue 1934-1935
Kushtimi:
Fr. âri 272.981

Godina e
Z. Adli Hatibit
në
Boulevard Zog I
ndertue: 1936

KRYEMINISTRIJA dhe MINISTRIJA e P. JASHTME
Pronë: Shtetnore – ndërtue: 30-VI-1931
për administrata të Kryeministris e të Ministris P. të Jashtme – Kushtimi Fr. ari 532,005,24

Në vitin 1930 u hapë dhe ndêrtue rruga ma e bukur dhe e gjanë: Boulevard Zog I. që fillon nga-Kodra e Pashës e shkon gjer në Brrakë.

Në këto artere të shtrueme në pjesën ma të madhe me plaka asfalti në mënyrën ma moderne të zbukurueme me druj ezotike, u goditën me mija shtëpijash me stile të ndryshme që i dhanë Kryeqytetit t' onë nji pamje krejt të ré.

MINISTRIJA e FINANCAVET
Pronë: Shtetnore – Ndërtue: 30-VI-1931
për administratë të Ministris së Financavet – Kushtimi: Fr. ari 407,531,27

KOMANDA e MBROJTJES KOMBËTARE
Pronë: Shtetnore – Ndërtue: 30-VI-1931
për administratë të Komandës Mbrojtjes Kombëtare = Kushtimi: Fr. ari 429.241.44

Në qendër të Boulevardit Zog I. në bazë të planit e të projekteve të arshitektit italjan me famë Z. Florestano De Fausto u ndërtuen gjashtë pallate të Ministrive në 1931 dhe pallati Bashkis në 1929-1931, u sistemue sheshi Skënderbej me nji

MINISTRIJA e P. MBRËNDSHME
Pronë: Shtetnore – Ndërtue: në 30-VI-1931
për administratë të Ministris së P. Mbrendëshme – Kushtimi: Fr. ari 426.250.82

MINISTRIJA E DREJTËSIS dhe e ARSIMIT - Pronë: Shtetnore – Ndërtue: 30-VI-1931
për administratë të Ministris së Drejtësis e Ministris Arsimit - Kushtimi: Fr. ari 420.580.85

MINISTRIJA E PUNVE BOTORE - Pronë: Shtetnore – Ndërtue: 30-VI-1931
për administratë të Ministris së P. Botore - Kushtimi: Fr. ari 431.531.81

BASHKIJA E KRYEQYTETIT
Pronë: bashkijake – Ndërtue: 1929-1931
për zyrat e Bashkisë
Kushtimi: Çpronësimi i truellit Fr. ari 10.000
Ndërtimi » » 370.265
Shuma 380.265

LULISHTA NË SHESHIN SKËNDERBEJ
Ku shifen punimet e asfaltimit dhe rregullimi i vëndit ku u ndërtue shadravani
data e mbarimit: 1936
dimensioni: gjatë m. 105.50 – gjanë m. 60

SHATRAVANI
në sheshin Skënderbej
ndërtue më 1937

Sheshi Skënderbej
(para Ministris P. Mbrendshme)
tue u asfaltue
viti 1937

Punimet e sheshit Skënderbej
(para Pallatit Bashkis)
dhe asfaltimi i saj
vlti 1937

park modern në 1936-1937 dhe në lagjen Tirana e Ré që ma parë quhesh Shallvare u ngrehën njena pas tjetrës e vazhdimisht shtëpija të nëpunsave të naltë, qi bashk me disa shtëpija privatësh të godituna ndër rruga tjera, përbajnë nji varg monumentash stili e bukurije me të cilin Kryeqyteti i jonë mund të mburret me shumë të drejtë.

Ndonse numri i shtëpijave tashti mbas 11 vjetësh, ka mërri (7654) prap ritmi konstruktiv vazhdon gjithnji gati si me hovin e parë tue e shtue ketë numër dita ditës. Sot me 28 Nanduer 1937 kryeqyteti banohet prej 24.407 banorë definitiv dhe 11.693 provizorë qi kështu gjithësej prej 36.200.

Kryeqyteti sot përshinë nji sipërfaqe prej km² 8 kurse në 1912 kishte vetëm 3 km².

Në këtë periudhë janë hapë e ndërtue dhe shumë rruga e sheshe tjera dhe ndërtesa publike me randësi kryesore.

Lulishta mbrapa Pallatit Bashkis

Shtëpijat e Nëpunsave
në Lagjen e Tiranës së Ré
ndërtue nga viti 1930-1937

Klinika dhe shtëpia e
Z. Dr. J. Basho
në rrugën
Gjeneral Telini
ndërtue më 1930

Shtëpijat e nëpunsave
në Lagjen e Tiranës së Ré
ndërtue gjatë viteve 1930-1937

Rruga Karnarvon
data e zgjanimit dhe e ndërtimit: 1925-1934
dimensioni: gjanë m. 12-15 gjatë 250 m.

kushtimi: çpronsimi	fr. ari	10,774
ndërtimi i rrugës, trotuarit e kanalit	» »	16,200
Shuma	» »	26,974

Pallati Mbretnuer

Rruga Karnarvon ndertue në 1925-2936 në krye të së cilës âsht hyrja kryesore e pallatit Mbretnuer dhe gjatë sajë ndërtesa e bukur e Dipartamentit Ushtarak, Parku publik, Pallati i N. N. T. T. Princeshave Mbretnore dhe Legata Italiane dhe krejt në fund Bibliotheka Karnarvon e ndërtueme me fondet e dhurueme prej të njoftunës mikeshës së shqueme të Kombit t'onë Lady Carnarvon në vitin 1928. Kjo âsht një rrugë kryesore e gjanë dhe zbukurue me druej të mjaftë dhe e shtrueme me asfalt në 1936, dhe i jep nji hijeshim kësaj ane të qytetit.

Departamenti Ushtarak
në rrugën Carnarvon
Pronë e N. N. S. S. Princeshave Mbretnore

LULISHTA POPULLORE
data e çeljes ose e zgjanimit: 1923
dimensioni: 2700 meter kare
kushtimi: fr. ari 8,000

Pallati i N. N. S. S. Princeshave në rrngën Carnarvon pronë e Komunitetit Musliman ndërtue më 1927

Adjudantura Mbretnore në rrugën Carnarvon pronë e Zoj. Hysref Frashëri

BISHT

VILA E N. S. I. PRINCESHËS SENIJE
ndërtuar më 1930



Shtëpija e Z. Major Allaman Çupit
në rrugën Karnarvon ndërtuar më 1930

BCSH

Biblioteka Carnarvon
në rrugën e
Shëngjergjit
pronë e personit moral
t'Institutit Herbert
ndërtue më 1928
kushtimi: fr. ari 40,000

Shtëpia e
Z. Rexhep Jellës
në sheshin e Tabakve
ndërtue më 1933

LEGATA ITALIANE
në rrugën Carnarvon
pronë e Shtetit Italian
ndërtue më 1929-930

Rruga HOXHA TAHSIN
data e çeljes e e zgjanimit: 1929-1937
dimensioni: gjatë 350 x 700-1050 ml. gjanë m. 15

kushtimi: çpronësimi		**fr. ari**	**48,967**
	ndërtimi-shtresa	**» »**	**47-000**
»	**trotuarit pjesa I.**	**» »**	**2,100**
»	**kanalit**	**» »**	**3,500**
	Shuma	**» »**	**191,567**

Rruga Hoxha Tahsin, e ri hapun dhe e zgjanueme në 1929-1937 fillon nga pazari i ri (sheshi Partheni) dhe mbaron ke vorrezet e bardha, ndërtimi së cillës âsht në mbarim e sipër; ka nji drejtim shumë të bukur që shkon gati paralel me até të rrugës Kotta.

Ndërtimi i rrugës Hoxha Tahsini
Pjesa e II – në vitin 1937

Kanali i rrugës Hoxhë Tahs'ni e Sir Aubrey Herbert në ndërtim 1937

Çelja e pjesës II të rrugës Hoxhë Tahsini viti 1937

Kanali i rrugës Hoxhë Tahsin në ndërtim 1937

Çelja e pjesës së fundit Hoxhë Tahsin në vitin 1937

Shtëpia e
Z. Gjeneral Zef Sereqi
në rrugën
Sir Aubrey Herbert
ndërtue 1930

Transportimi i tubave
të kanalit të rrugës
Sir Aubrey Herbert
në ndërtim 1937

Rruga:
Sir Aubrey Herbert
(e Pishës)
data e çeljes e
e zgjanimit: 1934-1935
dimensioni:
m. 700 gjatë m. 10 gjanë
kushtimi:
çpronsimi fr. ari 66,206
ndërtimi, shtres,
trotuar e kanal
fr. ari 30,000
shuma » » 96,206

Rruga General Alberto Pariani
data e zgjanimit: 1936
dimensioni: gjatë m. 680 gjanë m. 15

kushtimi: çpronsimi	**fr. ari**	**4,600**
ndërtimi i rrugës, trotuarit e kanalit	**» »**	**30,000**
shuma	**» »**	**34,600**

Në 1935 u zgjanue dhe sistemue rruga Gjeneral Alberto Pariani me 15 m. gjansi qi lidhë me nji kurb të kandëshme Boulevardin Zog I. me rrugën Gjon Bue Spata dhe até të Nanës Mbretneshë. Kjo rrugë ka me u zgjatue deri në rrugën Mbretnore. Asht pajosun me kanalin e vetë prej ml. 375 me diametër 0.60.



Shtëpia e Z. Omer Fortuzi
në rrugën Gjeneral Pariani
ndërtue 1931

Godina e VII. Kerçiku në sheshin Parthenië (e Merkatës) ndërtue 1935

Në sheshin Partheni që âsht në krye të rrugës Hoxhë Tahsin dhe qi tash përdoret për Pazarin e hapët (Merkatë) ndodhet ndërtesa madhështore e Drejtoris Përgjithshme Post-Telegrafeve dhe janë n'ërtue edhe ndërtesa tjera të mëdhaja dhe me stil të bukur.

Godina e Z. Banush Hamdiut në rrugën Sir Aubrey Herbert ndërtue 1935-1936

Drejtorija P. Post Telegraf Telefon në sheshin Partheni (e Merkatës) pronë e Z. Xhelo Dibrës ndërtue 1928

Rruga
Ibrahim Pashë Parga
(e Tafajve)
data e çeljes: 1928
dimensioni:
300 ml. gjanë 12 m.
kushtimi:

çpronsimi	**fr. ari**	**10,585**
ndërtimi	**» »**	**7,200**
shuma	**» »**	**17,785**

Në vitin 1928 âsht fillue hapja e rrugës Ibrahim Pashë Parga qi lidhë rrugën Xhemal Pashë Zogu me rrugën shumë të bukur dhe me plotë hijesinë të Bardyl-it.

Këjo e fundit âsht ndërtue në 1934 dhe bashkon dy ekstremet e rrugave Xhemal Pashë Zogu dhe Kotta.

Veç rrugave të shumta sekondare qi janë ndërtue në të gjitha anët nga periferi e qytetit âsht për t' u përmendë rruga Gjon Bue Spata (Shkodra) qi shkon gati paralel me rrugën Nana Mbretneshë bri së cilës âsht ndërtue me sistemim modernë ndërtesa e Burgut në 1930 me nji obor të mjaftueshëm.



Burgu i Përgjithshëm në rrugën Gjin Bue Shpata (e Shkodrës) pronë shtetnore ndërtue 1928

— Në 1934 âsht hapë dhe âsht fillue ndërtimi i Buolevardit Skenderbej qi i lidhë në drejtim gjysëm rrethi në mbarimin e tyne dy rrugat ma kryesore: Rrugën Nana Mbretneshë dhe Buolevardin Mussolini.

Me 28 Nanduer 1937 Kryeqyteti ka gjithseji 44 km. rrugë të ndriçueme me energji elektrike, prej të cilave kml. 30 janë rrugë shose dhe m² 36.500 janë rrugë t' asfaltueme me asfalt të minjerave të Selenices dhe m² 16.800 me pllaka asfalti dhe m² 4.000 me bloka guri.

Bulevardi Skënderbej

Kanalizimi

Një nga nevojat më kryesore të kryeqytetit âsht kanalizimi i përgjithshëm. Mbassi të shumat e rrugave u çelën dhe u zgjanuen me ngutsinë që imponon transformimi i Kryeqytetit, këto nuk u pajosën me kohë me kanalet e duhuna.

Po Bashkija, dalë nga dalë dhe në masa qi i lejon budgjeti i sajë tepër i vogël, filloi me ndërtue kanalet e rrugëve kryesore.

Buolevardi Zog I. dhe Buolevardi Mussolini qenë pajosun qysh në ndertimin e tyne me kanalet e nevojshme.

Rrugës Mbretnore iu ndërtue kanali në vitin 1932 me nji gjatësi prej ml. 1.100 dhe diametro 0.50 ashtu dhe kanali i rrugës Sir Herbert (Postës) prej m.l. 300

Në 1934 u ndërtue nji kanal i madh prej vorrezave deri në Lanë me gjatësi ml. 380 dhe gjanësi 0.80 ashtu dhe nji pjesë e kanalit të rrugës Xhemal Pashë Zogu me gjatësi ml. 335 dhe me tuba çimenteje me diametër 0.80. Po në këtë vit u

Ndërtimi i tubave të kanaleve të rrugave Koço Kotta, Hoxhë Vokrri e Hoxhë Tahsin në vitin 1937

Tubat e kanalit të rrugës Gjeneral Pariani në kantierin e Shoqnis SCAIA

Kanali i rrugës Bato në ndërtim 1937

Kandet e tratuarvet të rrugave Xhemal Pasha Zogu e Ibrahim Pashë Parga ndërtue në vitin 1937

ndërtuen dhe kanalet e nji pjesës të rrugës Koço Kotta, të rrugës Dhimitër Kamarda (Saraçit), dhe të rrugës 28 Nandor me nji gjatësi komplesive prej 642 ml. me tuba çementoje me diametër 0.40-0.50-0.60.

Në vitin 1937 Bashkija e Kryeqytetit ka angazhue me kontratë një ingjinjer specialist për pregatitjen e planit të përgjithshëm të kanaleve të Kryeqytetit. Në bazë të këtij plani këtë vit u ndërtuen kanalet e rrugëve Nana Mbretneshë, Gjeneral Pariani, Kont Urani, Bato me nji gjatësi ml. 1370 me tuba çementoje me diametër 0.50-0.80-1.05. Gjithashtu në bazë të këtij plani këtë vit u ndërtuen kanalet e rrugave Koço Kotta, Hoxhë Vokrri, Hoxhë Tahsin, dhe Sir Aubrey Herbert me nji gjatsi ml 1170 dhe me tuba diametro 0.60.

Në këtë mënyrë deri me 28 Nandor 1937 në Kryeqytet janë ndërtue kanale me nji gjatësi komplesive prej ml. 11.300.

Bashkija vit për vit tue vumë në zbatim planin e përgjithshëm të kanaleve në masa qi i lejon budgeti i sajë i ngushtë, në pakë kohë ka me plotësue dhe rrjetin e kanaleve të Kryeqytetit dhe kështu ka me sigurue një nga elementet ma të nevojshme për shëndetin publik.

Centrali Elektrik ndërtue 1927-1928 për ndriçimin e qytetit Kushtimi:
çpronsim truelli fr. ari 8,528
instalimet e bame me anë të Shoqnis Konçesionare «Sita» fr. ari 1,000,000
shuma fr. ari 1,008,528

Trotuarët

Gjithë rrugat e kryeqytetit dalë nga dalë janë tue u shtrue dhe zbukurue më trotuarë me shtresë çementoje ose pllaka çëmentoje dhe këtë vitin e fundit me shtresa asfalti. Kështu që me datën 28 Nanduer 1937 kryeqyteti ka nji sipërfaqe të përgjithëshme trotuarësh prej metro kuadrat 45.000 të shpërndamë në rrugat e poshtë shënueme: Boulevard Zog I, rruga Mbretnore, rruga Sir H. Herbert (Postës), 28 Nandor, Karnarvon, Boulevard Mussolini, Nana Mbretneshë Xhemal Pashë Zogu dhe Ibrahim Pashë Parga.

Trotuarët e këtyne dy rrugave të fundit, për herën e parë në kryeqytetin t'onë janë tue u mbulue me nji shtresë asfalti mbasi ky sistem në vënde të tjera ka dhanë përfundime të mira.

Ndriçim i Kryeqytetit

Në kohët e përparëshme Tirana, si gjith qytetet e tjerë të Shqipnisë, ndriçohej me anë të llampave me vojë guri. Kjo gjendje e pa pajtueshme me zhvillimin qi kish marrë kryeqyteti i rí i Mbretnis s'onë, nuk munt të vazhdonte dhe prandaj autoritetet eprore u kujdesuen edhe për plotsimin e kësaj mungese

Makinari i Centralit Elektrik

Në vitin 1927 koncesioni i ndriçimit elektrik, iu dha Shoqnís Anonime Shqiptare „Sita"

Spitali i Përgjithëshëm ZOG i I. pronë Shtetnore ndërtue 14-V-1932 kushtimi : Fr. ari 988,849,51

Instituti Baktereologjik pronë Shtetnore ndërtue 1934 për analizime e tjera kushtimi komplet Fr. ari 99,845,69

dhe u ndërtue në hyrje të qytetit, kur vjen nga Durrësi, Çentrali madhështor Elektrik me 1150 kuaj fuqi komplesive dhe u shpërnda drita e korentit elektrik në gjith qytetin në sistemin ma modern.

Sot 44 km. rrugë të kryeqytetit janë të ndriçueme me energji elektrike që rrjedhë nëpër nji rrjetë me nji gjatësi prej 44 km. dhe qi shpërndanë dritë me 802 llampa me fuqi të ndryshme prej 40 deri 500 Wat.

Për ndriçimin publik të rrugave dhe të shesheve të kryeqytetit në vitin 1936 janë konsumue 133,436 kw. orë energji elektrike dhe për ndriçimin privat ma se dy fish.

Ndër sa iu dha randësija ma e madhe zhvillimit dhe zbukurimit të kryeqytetit, Qeverija Mbretnore u kujdesue dhe për krijimin e instituteve shëndetsore e hygjenike tue plotsue nji të metë të madhe, po-thuej, për gjith kombin.

Deri vonë ka qenë në Tiranë nji Spital, ndërtesë private dhe krejt primitive, mbetun prej okupacioneve të hueja.

Ky Spital nuk i përgjigjej n'asnji mënyrë nevojave shëndetsore të popullit dhe ishin të shumtë ata qi vdisnin ose vuenin nga sëmundje të ndryshme që nuk mund të kuroheshin me këtë.

Nevojën e nji Spitali të plotsuem dhe që t'i përgjegjej nevojave të kohës

Spitali i Përgjithëshëm Ushtarak pronë Shtetnore ndërtue 26-IX-1929 kushtimi Fr. ari 548,894,88

Stasioni Radiotelegrafik

ishte ndi edhe prej popullit të kryeqytetit dhe kje formue në vitin 1927 nji komision për mbledhjen e ndihmave për ngrehjen e Spitalit.

Me ndihmat e mbledhuna prej fr. ari 132.937.25 në mbarim të rrugës Xhemal Pasha Zogu, kah fushat e gjata, ku asht vëndi më i naltë i Tiranës dhe qi ka për herë ajr të kulluët dhe të freskët, u çpronsuen kopshte dhe ara. Në vitin 1929 Qeverija Mbretnore filloj ndërtimin e Spitalit të Përgjithshëm Zog I. i përbamë prej shumë pavioneve dhe i pajosun me të gjitha instrumentet e nevojshme. Ky Spital që në 9 pavione përmbanë 300 shtrate pa droje mund të thuhet se asht nji nga ma të mirët të Ballkanit.

Në vitin 1934 kundrejtë Spitalit Përgjithshëm Zog I u ndërtue edhe Instituti Biokimik mbasi deri atëhere këtij shërbimi i mungonte lokali i nevojshëm dhe i përshtatshëm, ku sot bahen gjith farë analizash dhe pregatiten vaksina të ndryshme në mënyra të përsosura shkencore.

Gjithnji pranë Spitalit Përgjithshëm Zog I asht ndertue në vitin 1929 edhe Spitali i Përgjithshëm Ushtarak. Stili i ndërtesës përmbanë vijat kryesore të ndërtesave të Tiranës përparëshme të harmonizueme me mjeshtri me përparimet ma moderne t 'arhitekturës.

Ndër veprat edilitike me randësi të kryeme në kryeqytet nën regjimin krijuës ZOGIST, janë për t'u përmëndë Stasioni Radio-Telegrafik i ngrehun në fushën

Kazermat e Rea në rrugën e Kavajës ndërtue 1929-1932 kushtimi : Fr. ari 1,805,300

Kazermat e Xhenjos në rrugën Xhemal Pashë Zogu pronë Shtetnore ndërtue 1930-1932 kushtimi: Fr. ari 572,000

e Laprakës në vitin 1925 me nji fuqi kw³, i cili sot kryen pjesën ma të madhe të korespondencës telegrafike të jashtme, Grupi i Kazermave qi u ndërtuen gjatë këtyne dhetë vjetve të fundit në rrugën e Ndroqit dy km. jashtë qytetit.

Para së Tirana të bahej kryeqytet i Mbretnís këtu kishte vetëm nji Kazermë të mbetun nga sundimi Turk e cila nuk i përgjegjej eksigjencave të kohës së sotshme dhe nuk ishte ma e përshtatshme si e tillë, mbasi ishte shumë në qëndër të qytetit. Kjo ndërtesë, mbasi u lirue prej ushtrisë tash asht tue plotsue nji nevojë me randësi të kryeqytetit, mbasi në te u instalue Gjimnazi Shtetnuer.

Grupi Kazermave të Rea formon nji pamje mjaft tërhjekse kur hyhet në qytet nga rruga e Durrësit.

Veç këtyne nevojat e ushtrisë janë plotsue edhe me Kazermën 28 Nanduer afër Tiranës së Re ndërtue në 1926-1929.

Në këtë rend, meriton të përmënden dhe kezermat e Xhenjos Ushtarake, ndërtue në vitin 1937 në fund të rrugës Xhemal Pashë Zogu, ndërtesë në të cilën sot asht vendos dhe Instituti Teknik i Shtetit.

Kazermat e Artileris në rrugën e Kavajës pronë Shtetnore ndërtue 1928

Kazermat e Grupit Shkollave në rrugën e Kavajës pronë Shtetnore ndërtue 1928

Kazerma 28 Nanduer në Tiranën e Ré pronë Shtetnore ndërtue 1926-1929 kushtimi: Fr. ari 113,400

Auto-Reparti në rrugën e Durrësit pronë Shtetnore ndërtue 1927-1929 kushtimi: Fr. ari 334,000

B.I.SH



Fabrika e Miellit - në rrugën Nana Mbretneshë
pronë e Vll. Gjata – ndërtue 1930

Zhvillimi i Kryeqytetit ne shkallë shumë të gjanë i dha hov edhe krijimit të shumë Industrive qi nuk ekzistojshin fare përpara.

Tashti punohet me mjeshtri të mbarueme druni tue ndalue gati krejt importimin qi u bante në mobilje e sende tjera të punueme prej drunit; gjithashtu asht zhvillue edhe industrija e hekurit dhe ndodhen dy fabrika për punime të ndryshme hekuri.

Përveç këtyne janë ngrehë dhe dy fabrika miellit, me maqineri të mbarueme, njena në fund të Boulevardit Mussolini dhe tjetra në rrugën e Durrësit, pranë kësaj të fundit ndodhen dhe fabrikat e akullit.

Edhe industrija e hoteleris asht zhvillue mjaftë tue qenë se Tirana asht qyteti ma shumë i vizituem i Mbretnis.

Fabrika e Miellit – në fund të Boulevard Mussolini
pronë e Z. Xh. Menikut – ndërtue 1935

Fabrika e Akullit – në rrugën Nana Mbretneshë – pronë e Vll. Hobdari – ndërtue 1929

Nga hotelet ma kryesorët janë: Hoteli Kontinetal në rrugen Pjater Bogdani, Hoteli Internasional në rrugën Dhimitri Korona dhe Hoteli Tirana Pallas në rrugen Mbretnore.

Hotel Internacional – në rrugën Dhimitri Korona – pronë e Vllazën Mersini e Shokë

Hotel Tirana Pallas
në rrugën Mbretnore
pron' e
Z. Abdurrahman Matit
ndërtue : 1929

Hoteli
Kontinental
pronë e
Z. Vianzone

Pallati «Assikurazioni
Generali Trieste»
në rrugën
Pjeter Bogdani
ndërtue : 1933

Instituti Femnuer «Nana Mbretneshë»

Ndër sa Tirana asht zhvillue në të gjitha degat, përsa i përket ndërtesave shkollore ndertimet kanë qenë ma të pakët.

Janë për t'u përmendë Instituti Femnuer "Nana Mbretneshë", ndertue në 1922 në rrugen D'ESTOURNELLES de Constant, shkolla fillore Sulejman Pashë në rrugën Koço Kotta, ndërtue prej Bashkis në vitin 1928 — 1929 dhe shkolla foshnjore Hysen Nikolica që asht në ndërtim e sipër prej Zonjës Hysen Nikolica.

Si ndërtesa shkollore private, asht ngrehë prej nji shoqnije kolektive Tiranase ndërtesa e Konviktit Naim Frashëri në fund të Boulevardit Mussolini dhe shkolla femnore "Kyriazi, në Kodrën Pitoreske të Kamzës, 4 km. jasht Tiranës.

Me gjith këtë shpresohet se edhe problemi i ndërtesave shkollore ka me u zgjidhë për së shpejti mbassi edhe Bashkija ka çpronsuë që tash trojet e nevojshme për goditjen e ndërtesave shkollore.

Shkolla fillore Sulejman Pashë
Pronë: Shtetnore
Ndertue: 1928-1929.
(Prej Bashkis)
Kushtimi:
Fr. ari 34.990.

Konvikti «Naim Frashëri»
Në Boulevard Mussolini
Pronë e nji shoqënis kolektive
Ndërtue në 1928.

Kumanari i Orës Publike
Data e ndertimit : 1928
Kushtimi : Fr. ari 13,390.

Mauseleum i Nanës Mbretneshë. Ndertue: 1937.
Kushtimi: Çpronsimi i trullit e ndertimi Fr. ari 165,291.

Nji nga problemet ma më randësi qi preokupojnë Bashkin e Kryeqytetit asht ay i sjellies s'ujët të pijshëm.

N. M. T. Priësi i Madhë i Kombit t'onë, ashtu dhe Qeverija Mbretnore gjetjes dhe sjelljes s'ujit i kanë dhanë randësinë ma të madhe.

Ministrija e Punve Botore mbas shumë studimesh të bamuna me anë të ingjinjerëve kompetentë ka vendos sjelljen në kryeqytet t' ujit të pijshëm në kualitet fare të mirë prej burimëve të Selitës 22 km. larg në Lindje të kryeqyjetit. pikërisht prej kahë buron Lumi Risglatës Tiranës.

Për realizimin e këtij qëllimi Ministrija kompetente ka pregatitë dhe projektet përkatës.

Si mbas interesimit personal që tregon vetë Sovrani i Ynë AUGUST për këtë çeshtje jetike të kryeqytetit shpresohet me siguri se në nji kohë fare të shkurtë ky projekt ka me u vue në zbatim dhe kështu kryeqyteti bashkë me ujt e pijshëm të sjellun në sasië të mjaftushme për nji popullatë deri 50.000 frymësh ka m' u pajosë dhe me nji çentral të madh-Hydro elektrik me nji fuqi prodhuese energjië 40.000 KW. orë në ditë.

Thertorja
Pronë : Bashkijake
Ndërtue : 1929.
Qëllimi i përdorimit : Therje kafshësh.
Kushtimi: Fr. ari 14,735.

Zgjanimi e asfaltimi i Sheshit Kara Mahmut Pashës (para Xhamis Vjetër). Viti 1937.



Nevojtoret e reja ke Sheshi Kara Mahmut Pashës 1937

Legata Amerikane
në rrugën e Elbasanit
Pronë e Shteteve të
B. t' Amerikës
Fillue 1928, mbarue 1930.
Kushtimi me mobilje
20.000. = Fr. ari 130.000.

Legata Greke
në rrugën e Elbasanit
Pronë e
Z. Dr. S. Simonidhi
Ndertue: 1932-1933.
Kushtimi:
4.000. – napoleona =
20 X 4.000=80.000.



Pallati
Bankës Kombtare
tue u ndërtue 7-XI-1937
Pronë e Bankës
Kushtimi:
Fr. ari 520.000
Vendi qi okupon
m² 1500.

Bashkija e Kryeqytetit u mundue me rreshtue në ket album pjesët ma kryesore të veprave edilitike të kryeme këto vjetët e fundit në kryeqytet, nën regjimin e Ndriçëm Mbretnuer dhe në shumë raste drejtë për drejtë mbi Interesimin Personal të N. M. Tij Mbretit t'onë Gjenial.

Tue lanë me nji anë mungesat qi do të plotsohen dalë nga dalë mund të thuhet se kryeqyteti i Mbretnis s' onë në nji kohë shumë të shkurtë nën Udhzimet Gjeniale të N. M. TIJ Mbretit ZOG I. ka bamë përparime aqi të mëdhaja sa për ata që e mbajnë mend Tiranën e vjetër asht, po thuej, e pa njoftshme.

Me 28. Nanduer 1937 në bilançin e përgjithshëm të punvet të kryeme në 25. Vjetorin e parë të mvehtësis s' onë, sigurisht ndër ata qi dishmojnë zotsinë e gjallnin t' onë në mënyrën ma të shkëlqyeshme, asht edhe kryeqyteti i jonë i ri që i themeluem, i zbukuruem prej Shqiptarësh, rrin si nji monument i bukur i tenacitetit të nji race qi nuk shteret kurr n'enegjitë e veta.

Depot e Garazhet në rrugën e Durrësit Pronë Bashkiake. Ndertue: 1927-1931.
Qëllimi i përdorimit: Depo materialesh dhe sende ndezëze e garazhe.

Kushtimi:	**Çpronsimi**	**Fr. ari1179.80**
	Ndertimi	**» » 41313.70**
Shuma:		**» » 42493.50**

BISHT

Administrata e Bashkis

Në këto 25 vjet të vetë qeverimit Kombtarë dhe në këtë periudhë të rindertimit të kryeqytetit administrata Bashkiake asht drejtue prej Kryetarëve dhe Këshilltarëve të poshtë rreshtuem si mbas rendit kronologjisë.

1912 — 1914

Krytar: Zyber Effendi Hallulli.
Antar: Xhemal Aga Beshiri, Ibrahim Bajram Tafaj.

1915 — 1916

Kryetar: Z. Servet Libohova.
Kryetar: Z. Zyber Hallulli.
Antar: Xhemal Aga Beshiri, Ibrahim Bajram Tafaj.

1917 — 1922

Kryetar: Z. Ismail Ndroqi.
Antar: Abdulla Haxhi Mehmeti, Myslim Beshiri, Mahmut Shijaku, Hysen Gurabardhi e Selim Petrela

1922 — 1923

Kryetar: Z. Ali Begëja,
në vitin 1922
Antar: Xhemal Pazari, Abdulla Kazani, Myslim Dauti, Musa Vathi, Hamdi Saraçi e Ali Derhemi, — në vitin 1923 Sul Petrela, Sali Zala, Stefan Koja e Leonidha Nishku.

1923 — 1924

Zv. Kryetar: Z. Ali Derhemi
Antar: Xhemal Pazari, Abdulla Kazani, Myslim Dauti, Musa Vathi, Hamdi Saraçi, Sul Petrela, Sali Zala, Stefan Koja e Leonidha Nishku.

1924

Zav. Kryetar: Z. Beqir Rusi
Antar: Leonidha Nishku, Shtefan Koja, Osman Vaqarri, Sulejman Petrela e Xhemal Kondi.
Kryetar: Z. Xhemal Kondi
Antar: Leonidha Nishku, Stefan Koja, Osman Vaqari, Sul Petrela.

1925 — 1927

Kryetar: Z. Fuat Toptani
Antar: Hafiz Ibrahim Dalliu, Abdulla H. Mehmeti, Myslim Beshiri, Hysen Gurabardhi, Musa Vathi, Murat Begëja, Hamdi Saraçi, Alq Hobdari, Athanas Shundi e Sul Petrela.

1927 — 1928

Zv, Komisari: Z. Izet Dibra
Antar: Hafiz Ibrahim Dalliu, Abdulla H. Mehmeti, Alq Hobdarí, Musa Vathi, Sulejman Petrela, Athanas Shundi, Murat Begëja.

Misat e Asambles: 1) Z. Z. Dentist Athanas Prosi, 2) Faik Tomini, 3) Dr. Ismet Gega, 4) Av. Hamdi Binbashi, 5) Av. Emin Meta, 6) Dr. Athanas Shundi, 7) Qazim Tugu, 8) Musa Vathi, 9) Vehbi Hysa, 10) Mustafa Mora, 11) Osman Vaqarri, 12) Abdulla H. Mehmeti, 13) Beqir Kallçiu, 14) Hysref Frashëri, 15) Sulejman Petrela, 16) Ymer Ali Beqiri, 17) Hafiz I. Dalliu, 18) Abdulla Huta, 19) Selim Fërtuzi, 20) Ymer Fërtuzi, 21) Xhemal Mëniku, 22) Murat Begëja, 23) Ismail Juma, 24) Duf Jorgani.

1928 — 1930

Kryetar: Z. Rasim Kalakulla

Antar: Hamdi Binbashi, Athanas Shundi, Hysref Frashëri e Murat Begëja.

Misat e Asambles: 1) Z. Z. Ing. Eshref Frashëri, 2) Abdurrahman Mati, 3) Ismail Maçi, 4) Hamdi Binbashi, 5) Hafiz I. Dalliu, 6) Athanas Shundi, 7) Emin Meta, 8) Osman Vaqarri, 9) Murat Begëja, 10) Ramazan Konçi, 11) Qazim Tugu, 12) Ismail Juma, 13) Selman A. Petrela, 14) Hysref Frashëri, 15) Ymer Fortuzi, 16) Nijazi Tirana, 17) Ismail Petrela, 18) Shaqir Preza, 19) Hasan Zela, 20) Selim Furtuzi, 21) Vehbi Hysa, 22) Mehmet Ndroqi, 23) Beqir Kallçiu, 24) Ymer Ali Beqiri.

1930—1933

Kryetar: Z. Rexhep Jella

Antar: Ali Begëja, Dr. Athanas Shundi, Hysref Frashëri e Rexhep Pazari.

Misat e Asambles: 1) Z. Z. Abdurrahman Ma'i, 2) Rexhep Matja, 3) Ismail Maçi, 4) Ali Begëja, 5) Hafiz I. Dalliu, 6) Hamdi Binbashi, 7) Hysref Frashëri, 8) Dr. Athanas Shundi, 9) Dr. Sabri Tefiku, 10) Shaqir Preza, 11) Osman Vaqarri, 12) Selim Furtuzi, 13) Ramazan Keçi, 14) Ramazan Konçi, 15) Vil Lasku, 16) Rrok Berisha, 17) Rexhep Pazari, 18) Ymer Ali Beqiri, 19) Beqir Kallçiu, 20) Ymer Fortuzi, 21) Hysen Ali Mehmeti, 22) Nijazi Tirana, 23) Hiqmet Dibra.

1933 — 1935

Kryetar: Z. Abidin Nepravishta

Antar: Spiro Leka, Shaqir Preza, Osman Vaqarri e Hysref Frashëri

Misat e Asambles: 1) Z. Z. Abdurrahman Mati, 2) Rexhep Matja, 3) Hafiz I. Dalliu, 4) Rexhep Pazari, 5) Nijazi Tirana, 6) Hysref Frashëri, 7) Spiro Leka, 8) Dr. Athanas Shundi, 9) Ramazan Konçi, 10) Hamdi Petrela, 11) Qamil Turkeshi, 12) Ramazan Keçi, 13) Ismail Bogdani, 14) Osman Vaqarri, 15) Shaqir Preza, 16) Omer Fortuzi, 17) Tahir Gjinali, 18) Mati Logoreci.

Zyra Teknike

Kryetar: Ing. Palavicini
dhe Ing. Sadi Pashallari

1 9 3 6

Kryetar: Z. Ing. Qemal Butka

Antar: Spiro Leka, Shaqir Preza, Osman Vaqarri e Hysref Frashëri

Zyra Teknike

Kryetar: Ing. Anton Luffi

1 9 3 7

Kryetar: Z. Abidin Nepravishta

Antar: Shaqir Preza, Dr. Athanas Shundi, Hysref Frashëri, Kryesekretar Z. Zyber Bakiu.

Zyra Teknike

Zav. Kryetar: Ing. Vasil Noçka

Ingjinjer: Ing. Sadi Pashallari.

BIOGRAFIT



Z. ISMAIL NDROQI

Lindun në 1876 në Tiranë. Ka marrë dipllomë më 1908 prej Medreses Theologjike të Stambollit, ka shërbye si Myderis në Tiranë 1909, Myfti e Zav-Naipi në Shijak 1913, Myfti në Kavajë 1915, Myfti në Tiranë 1916, Kryetar i Bashkisë në Tiranë 1917 dhe Myfti po në Tiranë më 1914, më vonë asht emënuë Myfti në Durrës ku asht tue shërbyë dhe tash.

Z. ALI BEGËJA

Lindun më 1 Kallnuër 1888 në Tiranë, ka ba mësimet në Shkollën Qytetëse të Tiranës. Ka shërbyë 1911-1914, si Gjykatës Hetuës në Tiranë dhe mbasandaj asht marrë me professionin e avokaturës.

Më 1922, Kryetar i Bashkisë në Tiranë.

Më 1923, asht zgjedh assamblist në Kuvendin Kushtetuës dhe më 1 Gusht 1937, Deputet në Parlament, ku asht tue shërbyë dhe sot.

Z. ALI DREHEMI
Më 1923-1924
Zav. Kryetar Bashkije.

Z. FUAD TOPTANI

Lindun më 1863 në Tiranë, ka mbaruë shkollën Qytetëse të Tiranës dhe tre klasë në gjimnazin Ushtarak Turk në Manastir. Më 1884 asht zgjedh Kryetar i Bashkis në Tiranë, ku ka shërbyë tre vjet. Më 1915, Senator në Durrës, dhe më 1925-1927 Kryetar i Bashkis në Tiranë.



DKSH

Z. IZET DIBRA

Lindun më 1878 në Dibër të Madhe, ka mbaruë Gjimnazin e Manastirit dhe dy klasë të Fakultës së Drejtësis në Stamboll.

Ka shërbyë shumë vjet rresht si Krahinar dhe Nënprefekt i Turqis në Soroviç, Gramsh, Kozana, Allasonjë, Kjallar, Kërçovë, e Çall.

Në Mbretënin Shqipëtare ka shërbyë radhasi, Nënprefekt në Tiranë, Kryetar i Bashkisë në Shkodër, si Prefekt në Durrës, Elbasan, Berat, Shkodër, Komisar i Qeverisë pranë Bashkis së Tiranës, më von Prefekt i Kryeqytetit, Inspektor i Përgj. i Administratës, mbasandaj asht zgjedh si asamblist i Kuvëndit Kushtetuës, tue u emënuë më von Ministër i P. Botore, u zgjodh më von Deputet i Qarkut të Elbasanit, ma von asht emënuë Drej-Përgj. i Reformës Agrare dhe tash merr pjesë në Parlament si Deputet i Qarkut të Durrësit.





Z. RASIM KALAKULA

Lindun më 1884 në Gjinokastër, ka mbaruë më 1906 Shkollën e Naltë Politike (Mylqije) në Stamboll. Më 1920 Nënprefekt në Pogradec e më von radhasi: Zav. Prefekt në Korçë, Nënprefekt në Çamëri, në Libohovë, Sarandë, Zav-Prefekt në Gjinokastër, Shef i Seksionit në Ministrin e P. të Mbrendëshme, Prefekt në Shkodër, Zav-Prefekt në Vlonë, Inspektor i Administratës, Zav-Prefekt në Durrës, Prefekt i Kryeqytetit, prap Prefekt në Shkodër, dhe tash Anëtar i Kshillit të Shtetit.

Z. REXHEP JELLA

Lindun në Tiranë 1895. Ka Edukat Kolezhe Shqipni-Stamboll. Universitet: Angli.

1918-1920 Attache i dërgatës Shqiptare pranë Konferencës së Paqit.

1920 Delegat i Shijakut pranë Kongresit të Lushnjës, Prefekt i Durrësit, attache në Ministrin e P. të Jashtme, Inspektor i përgj. i zgjedhjeve të para të Parlamentit në Prefekturën e Elbasanit.

1921-23 Prefekt n' Elbasan e Durrës. Drejtor i P. Konsulore dhe i Protokolit pranë Ministris P. të Jashtme, Prefekt në Gjinokastër, Deputet i Durrsit, Asamblist i Durrsit.

1923-1924 Prefekt në Berat, Gjinokastër, Korçë, Tiranë. Prefekt i klasit I, Prefekt i Tiranës tue pasë dhe drejtimin e Bashkis, Drejtor i Përgj. i Entit Kombëtar Djelmënia Shqiptare.

1934-1937, Prefekt i kl. I. në Durrës dhe tash deputet.

Z. ING. QEMAL BUTKA

Lindun më 1908 në Kolonjë, ka mbaruë Shkollën e Naltë Teknike të Vjenës. tue marrë dipllomë me Titullin Ingjenieur në Fakultetin e Arkitekturës 1931. Ka shërbyë si Ingenieur-Arkitekt në Ministrin e P. Botore dhe më von më 1935-1936 si Kryetar i Bashkisë së Kryeqytetit dhe tash rishtazi si Ingjenieur-Arkitekt në Ministrin e P. Botore.

Z. ABEDIN NEPRAVISHTA

Lindur më 1889 në Kuç të Kurveleshit, ka mbaruë Gjimnasin dhe Shkollën e Naltë Politike (Mylqije) në Stamboll 1911.

Ka shërbyë në Perandorin Turke radhasi si Sekretar në Ministrin e Financavet në Stamboll, si Atashe në Vilajetin e Janinës dhe në Prefekturën e Beratit, njëkohësisht dhe si Profesor i Mathematikës në Gjimnasin e Beratit.

Në Mbretënin tonë ka shërbyë me radhë si Zav-Nënprefekt në Lushnje, në Ballsh 1913-1915. Asht marrë me tregëtië giatë okupacjoneve të huëja 1915-1920.



Më 1921 asht emënuë Nënprefekt Kl. I. në Tiranë dhe mbasandaj radhasi ka shërbyë si Prefekt në Elbasan 1922, në Shkodër 1922, Durrës 1923, prap në Shkodër 1923-1924 deri në kryengritjen e Qershuërit 1924.

Mbi plasjen e kësaj kryengritjes, mbasi luftoj 28 orë, i mbyllun me një pakicë shokë autoritetesh dhe officerash në Pallatin e Prefekturës, më në funt u shtrënguë me i dorëzuë administratën e Prefekturës së Shkodrës fuqive ushtarake kryengritëse dhe me u tërheq në Tiranë dhe mbas pakë ditë u detyruë, bashkë me shumë Autoritete të tjera, me u larguë nga atdheu për me u kthyë me fuqitë çliruëse të komanduëme prej Shpëtimtarit të Kombit N. M. T. Mbret Zogut I. më 24 Dhjetuër 1924.

1925, asht emënuë Drejtuër në Bankën Kombëtare të Shqipënis dhe më 1926 Prefekt në Durrës, ku shërbeu deri më Qershuër 1928.

Më 1929, bashkë me një grup tregtarësh Durrësakë formojti Shoqënin Anonime Ndërtimesh „Krahu", të cilën e drejtojti, si Drejtuër deri më 1 Tetuër 1930, datë në të cilën u emënuë Prefekt në Korçë.

Më von u transferuë në Prefekturën e Vlonës, ku shërbejti një vit e gjysmë si Prefekt dhe 7 muëj si Zavendës Kryetar i Bashkis.

Më 11 Shtatuër 1933 u emënuë si Kryetar i Bashkis së Kryeqytetit, ku shërbejti deri më 9 Dhjetuër 1935.

Më datën 21 Kallnuër 1937 u emënuë rishtazi Kryetar i Bashkis së Kryeqytetit ku asht tue shërbyë dhe tash.

P. S. Pjesa historike e këtij Albumi asht shkrue prej Z. Osman Myderizit dhe pjesa edilitike asht nxjerrë prej regjistrave të Seksioneve të kësaj Bashkije.

Kryetar' i Bashkis Kryeqytetit

Abidin Nepravishta

BKSH

BKSH

BKSH

BKST